

VENDIM
Nr. 98, datë 16.4.2021

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 47/4 prot., datë 12.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 23.3.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/11 prot., datë 23.3.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezultoi të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 500 prot., datë 31.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 80/2021.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 500/1 prot., datë 8.4.2021, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”), plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”), plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Dragobia Energy” në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti